



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 702 Dt. 06.12.2022

PRISHTINË • PRISTINA • PRISTINA

KOMISIONI I GARAVE

2022-23

Prishtinë, 06/12/2022

VENDIM Nr. 8/2022

Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të Federatës së Basketbollit të Kosovës, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e vet të mbajtur në datën e lartpërmendur, në përbërje të plotë prej Kryesuesit Leart Hoxha dhe anëtarëve Valdet Spahija dhe Ylli Hoti (pjesëmarrje online) shqyrtoi dhe miratoi këto vendime dhe rekomandime:

1. Miratohet kërkesa e KB Sigal Prishtina për shtyrje të ndeshjes me KB Peja. Ndeshja shtyhet për një datë të përshtatshme, për të cilën Komesari i Garave duhet të vendosë, sipas dispozitave të nenit 10 të Propozicioneve të Garave.
2. Komisioni ka shqyrtuar situatën me obligime të pashlyera financiare të klubeve ndaj FBK-së, konform kompetencave të veta ka vendosur që të gjitha klubet e Superligës obligohen që deri një 24 orë para fillimit të xhiros XV, duhet të shlyejnë këto obligime ndaj FBK-së:
 - a) Këstin e muajit tetor nga marrëveshja me FBK-në për shlyerje të obligimeve
 - b) Borxhet nga informatorët e deritashëm
 - c) Borxhet për licencime dhe
 - d) Borxhet tjera të këtij sezoniKlubet që nuk shlyejnë obligimet e lartë-cekura ndaj FBK-së, do të suspendohen nga garat, konform dispozitave të marrëveshjes dhe/ose dispozitave të nenit 46 të Propozicioneve të Garave.

Në emër të Komisionit të Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës:

Leart Hoxha
Kryesues i Komisionit

KËSHILLË JURIDIKE

Palët e pakënaqura me Vendimet e Komisionit të Garave mund të parashtrajnë ankesë pranë Komisionit Arbitrar të FBK-së, në formën dhe brenda afateve të përcaktuara me aktet normative të FBK-së.

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors



Silver Sponsors



South Basketball supporters





FEDERATA E BASKETBOLLIT TE KOSOVËS
KOSOVA BASKETBALL FEDERATION
KOSARKASKA FEDERACIJA KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 702 Dt. 06.12.2022
PRISHTINË • PRISHTINA • PRISTINA

ARSYETIMI I KOMISIONIT TË GARAVE VENDIMI Nr. 8/2022

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 1 të Vendimit Nr.8/2022, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I: KB Sigal Prishtina e ka dërguar kërkesën me kohë dhe ka dëshmuar se është duke u paraqitur në Ligën ENBL.

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 2 të Vendimit Nr.8/2022, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

I: Klubet e Superligës, i janë nënshtruar kriterëve për licencim për sezonin 2022/23, të miratuara nga Bordi i FBK-së. Pjesë e kriterëve për licencim ka qenë edhe shlyerja e një pjese të obligimeve financiare të klubeve nga sezonet paraprake dhe arritja e një marrëveshjeje me FBK për ri programim të pjesës së mbetur të borxhit.

II: Secili klub ka nënshkruar marrëveshje veç e veç me FBK-në duke u thirrur në parimet e cekura më lart dhe secili klub ka pasur afatet përkatëse dhe shumat përkatëse që është dashur ti paguajë çdo muaj kalendarik.

III: Marrëveshjet për shlyerje të obligimeve parashohin suspendimin si masë, në rast se klubi nuk respekton afatet e marrëveshjes.

IV: Propozicionet e Garave, vendimet e Komisionit dhe informatorët obligojnë klubet që të shlyejnë obligimet financiare ndaj FBK-së dhe parashohin suspendimin e klubit në rast të mos respektimit të vendimeve të Komisionit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Youth Basketball supporters:

